



01 Nr. 609/24 Dt. 02.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja g të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të nenit 40 të Ligjit nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, dispozitave të Rregullores për Shërbime Publike dhe Komunale në Komunën e Prizrenit 001/011-73507 dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave

- Formohet dhe emërohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të parashtruar ndaj akteve administrative të marra nga ana e Inspektoratit komunal të mbrojtjes së mjedisit, Inspektoratit komunal të ndërtimit dhe Inspektoratit komunal për shërbime publike (inspektorëve komunal) të Komunës së Prizrenit. Anëtarë të këtij Komisioni emërohen:
 - 1.1. Fatmir Memaj,.....kryesues,
 - 1.2. Artan Gashi,.....anëtar,
 - 1.3. Afërdita Mormorina,.....anëtare.
 - Komisioni, nga pika 1 e këtij Vendimi, do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me Ligjin 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit, Rregullores për Shërbime Publike dhe Komunale në Komunën e Prizrenit 001/011-73507 dhe ligjet dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.
 - Mandati i Komisionit është 2 (dy) vjeçar me të drejtë vazhdimi.
 - Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet vendimi i kryetarit të Komunës 01 nr.577/24 i datës 23.09.2024.
 - Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
 - Obligohet Drejtoria e Inspektorateve si dhe të emëruarit për zbatimin e këtij vendimi.
 - Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.
- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Inspektorateve,
 - Të emëruarve,
 - Arkivës së Kryetarit .

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

